


Ankesat e trajtuara nga Klinika e Ligjit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në harkun kohor Korrik-Dhjetor 2022

Përgjatë këtij harku kohor në Klinikën e Ligjit janë përcjellë dhe janë trajtuar 63 ankesa në total. Ndaj tyre, KShH ka realizuar një sërë shërbimesh, si këshillim ligjor falas, ndërhyrje në institucione shtetërore, verifikim në vend, përfaqësim gjyqësor, etj., gjithnjë pa veçuar reagimin publik. Dominojnë ankuesit e rritur meshkuj me 86% të totalit, ndërsa pjesa i përket kombësisë së ankuesve vetëm 2% e ankesave janë drejtuar nga persona të pakicave kombëtare.



Më së shumti ankesat lidhen me shkeljen e të drejtave në sistemin penicitar me 70% të totalit. Pranë Klinikës janë adresuar dhe ankesa të natyrës civile, të cilat përfaqësojnë 13% të totalit.

Në pjesën më të madhe të shqetësimeve të adresuara nga qytetarët është ofruar këshillim ligjor. (44 % të rasteve në total si dhe është trajtuar ankesa në 41% të rasteve.



Pjesa i përket shtrirjes gjeografike rreth 19% e ankesave janë përcjellë nga Tirana, i cili rezulton qyteti me më shumë ankues, ndjekur nga Burreli me 17% dhe Shkodra me 16% të totalit të rasteve.

71% e ankesave janë drejtuar nga shtetas të cilët ndodhen në institucionet penicitare dhe 16% nga shtetas në gjendje të lirë.

Dominojnë ankesat me objekt cënimin e nenit 3 të KEDNJ-së (Ndalimi i torturës) dhe nenit 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), me 13% dhe 11% të totalit.



Githashtu në shumë situata u hasën ankesa me objekt cënimi neni 6 të KEDNJ-së (e drejta për një proces të rregullt ligjor) me 11% të totalit të rasteve.